



UNIVERSITETI  
UNIVERSITY  
UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"

Nr. 1350 dt. 22.07 20 16

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"**

**Senati**

**Ref. Nr. /2015**

**Pejë, 20.07.2016**

Në bazë të nenit 42, nenit 48 pika 1.8, te Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Senati në mbledhjen e mbajtur me datë 20.07.2016 nxori këtë:

**V E N D I M**

- I. Miratohet Rregullorja për Botime në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.
- II. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Menaxhmenti dhe njësit akademike të Universitetit.
- III. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Senatit të UHZ-së, ndërsa zbatimi i Rregullores nga pika 1 e këtij Vendimi do të bëhet nga data 01.10.2016.

Vendimi i dërgohet:

- Rektorit
- Prorektorit për mësimdhënie
- Njësive akademike të UHZ-së
- Arkivit të UHZ-së



Rektor  
Prof. Asoc. Dr. Fadil Millaku



UNIVERSITETI  
UNIVERSITY  
UNIVERZITET  
"HAXHI ZEQA"

Nr. 1360 dt. 22.07.2016

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEQA"**

**Rektor:**

**Prof. Asoc. Dr. Fadil Millaku**

Në bazë të nenit 231 dhe 232 të Statutit, Senati i Universitetit "Haxhi Zeqa", në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me 20.07.2016, miratoi këtë:

**RREGULLORE PËR PUBLIKIMET E UNIVERSITETIT  
"HAXHI ZEQA" NË PEJË**

**Dispozitat e përgjithshme**

**Neni 1**

1.1. Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet dhe procedura e botimit, ribotimit dhe përkthimit të teksteve bazike, të teksteve të tjera, praktikumeve, përmbledhjeve të detyrave dhe të publikimeve të tjera të veçanta (monografi dhe periodike), të karakterit profesional, shkencor, letrar, artistik dhe informativ (në tekstin e mëtejshëm: publikimet).

1.2. Botues i këtyre publikimeve është Universiteti "Haxhi Zeqa" në Pejë.

**Neni 2**

2.1. Publikimet botohen në bazë të planit botues.

2.2. Planin botues e miraton Këshilli Botues i Universitetit "Haxhi Zeqa" në Pejë, (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli Botues), për çdo vit akademik, sipas propozimeve të njësive akademike dhe të njësive organizative.

2.3. Plani botues propozohet nga njësitet akademike në nëntor, ndërsa vlen për vitin vijues kalendarik.

**Neni 3**

3.1. Në publikimet e teksteve bazike, të teksteve të tjera, praktikumeve, përmbledhjeve të detyrave përfshihet materia e një lënde mësimore, përkatësisht e fushës së caktuar.

3.2. Publikimet duhet t'i përmbajnë arritjet profesionale, shkencore, letrare dhe artistike, në pajtim me kërkesat bashkëkohore metodologjike dhe pedagogjike.

3.3. Autorë të teksteve mund të jenë mësimdhënësit në marrëdhënie të rregullt pune në UHZ. Në raste të veçanta, autor/bashkautorë mund të jenë edhe nga stafi i pensionuar i UHZ-së.

**Këshilli Botues i Universitetit**

**Neni 4**

4.1. Këshilli Botues përbehet nga 5 anëtarë me të drejte vote. Prorektori për mësimdhënie ose prorektori për kërkime shkencore është anëtar i Këshillit Botues sipas detyrës zyrtare dhe ka të drejte vote. Këshilli vendos me shumice votash. Në rast se numri i votave është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare.

Adresa: Rr. "UÇK-së" 30000 Pejë

www.unhz.eu ; E-mail: info@unhz.eu ; Tel. : +381/39/423 270

4.2. Anëtarët e Këshillit Botues i propozon Rektori, ndërsa i zgjedh Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, sipas fushave përkatëse të shkencës dhe të artit.

4.3. Mandati i anëtarëve të Këshillit zgjat katër vjet.

4.5. Kryetari i Këshillit Botues zgjidhet nga anëtarët e tij.

#### **Neni 5**

5.1. Këshilli Botues, përveç të tjerash, e shqyrton dhe e lejon botimin e publikimeve në baze të pëlqimit me shkrim të këshillit të njësisë akademike, më së paku dy recensentëve të fushës përkatëse dhe të redaktorit.

5.2. Këshilli Botues vendos për zgjedhjen ideore të ballinës dhe për redaktuarën e tekstit.

#### **Neni 6**

6.1. Anëtarët e zgjedhur të Këshillit Botues janë njëkohësisht edhe redaktore të publikimeve universitare nga fusha shkencore, profesionale e artistike, të cilës i përkasin.

6.2. Për shkencat që nuk janë përfshirë sipas paragrafit 2 të nenit 4, në raste të caktuara, Këshilli emëron redaktor profesional.

6.3. Recensentët dhe redaktori mbajnë përgjegjësi për cilësinë e dorëshkrimeve, për nivelin profesional dhe shkencor të dorëshkrimeve.

6.4. Redaktori, në baze të vlerësimit pozitiv të recensentëve dhe të analizës së dorëshkrimit, i jep mendim me shkrim Këshillit Botues për lejimin e botimit të dorëshkrimit.

6.5. Punën e vet redaktuese për një dorëshkrim redaktori është i obliguar ta kryejë brenda afatit prej 30 ditësh nga dita kur e merr dorëshkrimin e kompletuar.

6.6. Autori mban përgjegjësi për cilësinë dhe për origjinalitetin e punimit.

#### **Neni 7**

7.1. Këshilli Botues jep ide, mendime dhe pikëpamje për politiken dhe për avancimin e publikimeve universitare.

7.2. Këshilli Drejtues dhe Senati e mbështesin Këshillin Botues për realizimin e publikimeve universitare.

7.3. Këshilli Botues për punën e vet i përgjigjet Senatit.

### **Procedura e botimit të publikimeve**

#### **Neni 8**

8.1. Lejen për botimin e publikimeve e jep Këshilli Botues i Universitetit.

8.2. Dorëshkrimet e publikimeve nga neni 1 i kësaj Rregulloreje i nënshtrohen recensimit, të cilin e bëjnë se paku tre anëtarë të fushës përkatëse.

8.3. Recensentët i cakton këshilli i njësisë akademike.

8.4. Recensentët kane obligim që të shkruajnë recension pozitiv apo negativ. Raporti i tyre mund të jetë i përbashkët apo i ndare.

8.5. Raporti i recensentëve duhet të dorëzohet brenda afatit të precizuar në vendimin për emërimin e tyre.

8.6. Dorëshkrimi pranohet në procedurën e mëtejme për botim nëse i ka pozitive se paku dy recensionet.

#### **Neni 9**

9.1. Autori duhet ta dorëzojë dorëshkrimin dhe recensionet pozitive se paku prej dy recensentëve. Dorëshkrimi duhet të jetë i shtypur në letër (me lidhje të bute) dhe në version elektronik origjinal (Word, Late X etj.) dhe PDF (dhe i radhitur me kompjuter).

9.2. Dorëshkrimi i teksteve bazike, i teksteve të tjera, i praktikumeve dhe i përmbledhjeve të detyrave duhet të jetë në pajtim me planin dhe programin e lëndës mësimore, përkatësisht të asaj fushe.

9.3. Dorëshkrimi duhet të jetë i lekturuar dhe i korrektuar.

9.4. Autori, bashkë me dorëshkrimin sipas pikës 3 të këtij neni dhe me recensionet duhet ta dorëzojë edhe planin e programin mësimor të lëndës përkatëse, të asaj fushe, të vërtetuar nga njësia akademike.

9.5. Me rastin e aplikimit, autori/autorët nënshkruan/nënshkruajnë deklaratë për origjinalitetin e punimit dhe për përgjegjësitë e tjera.

9.6. Këshilli botues harton dhe aprovon formulat për procesin e aplikimit.

#### Neni 10

10.1. Në rast se redaktori i bën vërejtje autorit ose recensentëve për dorëshkrimin, kurse ata nuk veprojnë sipas vërejtjeve e sugjerimeve në afatin e caktuar, konsiderohet se heqin dorë nga procedura e mëtejme.

10.2. Për rastet e mospajtimit eventual të autorit dhe të recensentëve me vërejtjet e redaktorit, sipas paragrafit 1 të këtij neni, vendos Këshilli Botues.

#### Neni 11

11.1. Përparësi botimi kanë: publikimet origjinale, sidomos për lëndët mësimore që nuk kanë tekst bazë universitar dhe publikimet të cilat me plane dhe programe mësimore janë literature e domosdoshme për studente;

11.2. Përkthimet e teksteve bazike me rëndësi të veçantë profesionale, shkencore, letrare dhe artistike.

#### Neni 12

12. 1. Publikimet e Universitetit përmbajnë: emrin e Universitetit, emrin e njësisë akademike, emrin dhe mbiemrin e autorit/autoreve, titullin e tekstit, stemën e Universitetit, vendin dhe vitin e botimit.

2. Faqja e parë dhe e dytë janë të zbrazëta.

3. Faqja e tretë është e njëjtë sikurse ballina, por pa ngjyra.

4. Faqja e katërt: emrat e recensentëve, të kryetarit të Këshillit Botues, të redaktorit, të botuesit (Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë) dhe në fund numrin e vendimit me këtë përmbajtje: Këshilli Botues i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, lejoi publikimin dhe përdorimin e këtij teksti me vendimin nr. të datës xx.xx.xxxx.

5. Faqja e pestë: përmbajtja.

6. Pas përmbajtjes pason parathënia në faqen numër tek (ne anën e djathtë), teksti i publikimit, kurse pas tekstit - literatura, indeksi i emrave, indeksi i nocioneve dhe në faqen e fundit - emri dhe mbiemri i autorit, titulli i publikimit, emri dhe mbiemri lektorit, i korrektorit, i redaktorit artistik, i realizuesit kompjuterik dhe i autorit të ilustrimeve.

7. Falënderimi për sponsoret mund të jetë në faqe të parafundit.

8. Në faqet e tekstit figuron emri i autorit dhe titulli i publikimit.

9. Në publikim jepet edhe ky shënim: Të gjitha të drejtat e autorit mbrohen me ligj.

10. Format i botimeve të Universitetit është BS (17 x 24 cm). Radhitja duhet të bëhet sipas fontit Century Gothic, me madhësi të shkronjave 11, me rrallo 1.0.

11. Botimet e veçanta mund të kenë zgjidhje teknike e artistike të veçantë.

12. Në faqen e fundit të publikimit botohet katalogimi (CIP) në Bibliotekës Kombëtare të Kosovës, kurse ISBN-ja edhe në kopërtinën e prapme.

## Financimi i botimit të publikimeve

### Neni 13

13.1. Vlerësimi i shpenzimeve të botimit të shprehet në valutën (euro-€) dhe për bazë llogaritjeje merret faqja e tekstit të botuar.

13.2. Caktimi i pikëve bëhet si në vijim:

13.2.1. Për redaktor - 1 € për faqe.

13.2.2. Për recensentë - 2 € për faqe (shuma pjesëtohet varësisht nga numri i recensentëve).

13.2.3. Për lekturë dhe korrekturë - 1 € për faqe.

13.2.4. Për honorarin e autorit/autoreve:

i) 1500 EUR për tekstet me 70-99 faqe;

ii) 3000 EUR për tekstet me 100-250 faqe; dhe

iii)  $3000 + 5(X-250)$  EUR, për tekstet me më shumë se 250 faqe (ku X është numri i faqeve të tekstit).

13.2.8. Për përmbledhje detyrash, praktikume:

i) 1000 EUR për tekstet me 70-99 faqe;

ii) 2000 EUR për tekstet me 100-250 faqe; dhe

iii)  $2000 + 5(X-250)$  EUR, për tekstet me më shumë se 250 faqe (ku X është numri i faqeve të tekstit).

13.3. Për përkthim të tekstit universitar honorari do të jetë 12 € për faqe.

13.4. Honorari i autorit/autoreve për botimin e dyte do të jetë 50% të vlerës së honorarit për botimin e pare.

13.5. Honorari i autorit/autoreve për botimin e tretë e tutje do të jetë 30% të vlerës së honorarit për botimin e pare.

13.6. Për botimin e dyte e tutje kompensohet vetëm autori/autorët, e jo redaktori, recensentët, lektorët dhe korrektoret.

13.7. Në rast të kërkesave për përkthim, autori/autorët paraprakisht duhet ta kontaktojnë shtëpinë botuese apo autorët dhe të informohen për kushtet e bartjes së të drejtës për përkthim, të cilat do të merren parasysh në vendimin e Këshillit Botues të UHZ-se. Nëse KB-ja merr vendim pozitiv, atëherë UHZ-ja (përmes KIs-se) i drejtohet shtëpisë botuese apo autorëve me kërkesë zyrtare për të drejtën për përkthime. Vetëm pas marrjes së lejes, autori/autorët do të mund ta fillojnë përkthimin dhe pasi ta kenë finalizuar, ta bëjnë kërkesën e ardhshme në Këshillin Botues, duke ia bashkëngjitur edhe raportin e recensentëve dhe duke i përmbushur kërkesat e tjera sikur në rastin e publikimeve të tjera.

13.8. Rektorati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, e kompenson autorin/autorët edhe me 50 % të mjeteve të realizuara nga shitja e publikimit. Kompensimi behet çdo vit pas nxjerrjes së bilancit të shitjes.

13.9. Nëse shpenzimet e publikimit i ka mbuluar autori, 80% e mjeteve të realizuara nga shitja do të shkojnë te autori, ndërsa 20% i takojnë Universitetit.

13.10. Nga çmimi kushtues i shitjes së publikimit i takon:

13.10.1. Universitetit- 85% nga çmimi shitjes së publikimit;

13.10.2. Rrjetit të shitjes - 15 % nga çmimi i shitjes.

13.11. Prej momentit të themelimit të Librisë Universitare (në kuadër të Bibliotekës Universitare), shitja e publikimeve do të bëhet vetëm në atë librari dhe mjetet derdhen në llogarinë e Universitetit.

13.12. Mjetet nga shitja e publikimeve i kthehen Rektoratit sipas dinamikës së shitjes së publikimit.

13.13. Në cilëndo mënyrë të financimit të publikimeve (me financim të UP-së apo vetëfinancim), çmimi i shitjes dhe vendi i shitjes caktohet në mënyrë të njëjtë (dhe në bazë të kësaj rregulloreje), ndërsa autori/autorët nuk kanë të drejtë që ta shesin vetë librin dhe as ta imponojnë blerjen e tij nga studentet,

#### **Neni 14**

Financimi i publikimeve bëhet nga mjetet e buxhetit të Universitetit dhe nga burimet e tjera (sponsorë, donatorë, mjetet e grumbulluara nga shitja e teksteve etj.). Mjetet e grumbulluara nga sponsoret dhe nga shitja arkëtohen në konto të veçante të Universitetit dhe shfrytëzohen për përkrahje të botimeve të reja.

#### **Neni 15**

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen edhe për publikimet që botohen me mjete të autorit, me përjashtim të nenit 13 (paragrafëve përkatës) dhe nenit 14 të kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 16**

16.1. Çmimi i shitjes për çdo publikim llogaritet sipas shumës së mjeteve financiare nga 0.015-€ për faqe të tekstit të botuar.

16.2. Çmimet dhe obligimet e tjera mes botuesit, autorit dhe subjekteve të tjera të parapara me këtë Rregullore përcaktohen me kontratë.

#### **Neni 17**

17.1. Rektorati i Universitetit (Sektori i financave) e bën kompensimin e shpenzimeve të publikimit për shtypjen e publikimit në përputhje me procedurat përkatëse. Përgjegjës për mjetet financiare lidhur me botimin është prorektori për çështje materiale-financiare.

#### **Neni 18**

18.1. Çdo publikim, i cili u referohettributeve të parapara me këtë Rregullore pa kaluar nëpër procedurat e parapara, konsiderohet publikim pa leje dhe nuk e ka validitetin universitar, përkatësisht merren masa ligjore.

18.2. Pas botimit, në rastet kur publikimi mbështetet financiarisht nga UHZ-ja, botuesi është i obliguar t'ia dorëzojë:

18.2.1. Autorit të publikimit - 10 kopje;

18.2.2. Rektoratit - 1 kopje;

18.2.3. Bibliotekës së njësishë akademike përkatëse 5 kopje;

18.2.4. Bibliotekës Kombëtare të Kosovës - 3 kopje;

18.2.5. Bibliotekës Qendrore të UHZ-se - 5 kopje.

18.3. Në rastet kur publikimet universitare botohen me vetëfinancim, autori është i obliguar t'ia dorëzojë:

18.3.1. Rektoratit - 1 kopje;

18.3.2. Bibliotekës së njësishë akademike përkatëse 5 kopje;

18.3.3. Bibliotekës Kombëtare të Kosovës - 3 kopje;

18.3.4. Bibliotekës Qendrore të UHZ-se - 5 kopje.

### **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

#### **Neni 19**

19.1. Për zbatimin e drejtë të kësaj Rregulloreje kujdeset kryetari i Këshillit Botues.

19.2. Interpretimin autentik të kësaj Rregulloreje e jep Senati i UHZ-së.

## Neni 20

- 20.1. Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje bëhet sipas procedurës së miratimit.
- 20.2. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati i UHZ-së dhe vlen për publikimet e miratuara pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.



Rektor:

Prof. Asoc. Dr. Fadil Millaku



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET  
"HAXHI ZEKA"**

---

Senate

Ref. 1360

Datë: 22.07.2016

---

**REGULATION FOR PUBLICATIONS OF "HAXHI ZEKA" UNIVERSITY IN PEJA**

Peja, 2016



Pursuant to Articles 231 and 232 of the Statute, the Senate of "Haxhi Zeka" University in Peja, at its meeting held on 20.07.2016, approved the following:

## **REGULATION FOR PUBLICATIONS OF "HAXHI ZEKA" UNIVERSITY IN PEJA**

### **General Provisions**

#### **Article 1**

1.1. This Regulation defines the conditions and procedure for publishing, reprinting and translating basic texts, other texts, practices, task summaries and other special publications (monographs and periodicals), of a professional, scientific, literary, artistic and informative character (hereinafter: publications).

1.2. Publisher of these publications is "Haxhi Zeka" University in Peja.

#### **Article 2**

2.1. Publications are published according to the publishing plan.

2.2. The publishing plan is approved by the Publishing Council of "Haxhi Zeka" University in Peja, (hereinafter: the Publishing Council), for each academic year, as proposed by the academic units and the organizational units.

2.3. The publishing plan is proposed by the academic units in November and is valid for the following calendar year.

#### **Article 3**

3.1. Publications of basic textbooks, other textbooks, internships, and task summaries include the subject matter of a particular subject area.

3.2. Publications must contain professional, scientific, literary and artistic achievements, in accordance with contemporary methodological and pedagogical requirements.

3.3. The authors of the textbooks can be teachers in full time employment at UHZ. In exceptional cases, author / co-authors may also be from retired UHZ staff.

### **University Publishing Council**

#### **Article 4**

4.1. The Publishing Council is composed of 5 voting members. Vice Rector is a member of the Publishing Council ex officio and has the right to vote. The Council decides by a majority of votes. If the number of votes is equal, the vote of the chairman is decisive.

4.2. The members of the Publishing Council are proposed by the Rector, while being elected by the Senate of "Haxhi Zeka" University in Peja, according to the relevant fields of science and art.

4.3. The term of office of the members of the Council shall be four years.

4.5. The President of the Publishing Council is elected by its members.

### **Article 5**

The Publishing Council shall, inter alia, consider and permit the publication of publications on the basis of consent

- 5.1. Written by the academic unit council, to at least two relevant field reviewers and the editor.
- 5.2. The Publishing Council decides on the conceptual choice of front page and the text editor

### **Article 6**

- 6.1. Selected members of the Publishing Council are also editors of university publications in the scientific, professional and artistic fields to which they belong.
- 6.2. For the sciences not covered by paragraph 4 of Article 4, in certain cases, the Council shall appoint a professional editor.
- 6.3. The reviewers and the editor are responsible for the quality of the manuscripts, for the professional and scientific level of the manuscripts.
- 6.4. The editor, based on the positive reviews of the reviewers and the manuscript analysis, gives a written opinion to the Publishing Council on allowing the publication of the manuscript.
- 6.5. The editor is obliged to complete his / her editing work for a manuscript within 30 days of receiving the completed manuscript.
- 6.6. The author is responsible for the quality and originality of the work.

### **Article 7**

7 .1. The Publishing Council provides ideas, opinions and views on politics and the advancement of university publications.

The Governing Council and the Senate support the Publishing Council for the realization of university publications.

- 7.2. The Publishing Council reports to the Senate on its work

### **Procedure for edition of publications**

#### **Article 8**

- 8.1. Publication permission is given by the University Publishing Council.
- 8.2. Manuscripts of publications referred to in section 1 of this Regulation shall be subject to review by at least three members of the relevant field.
- 8.3. The reviewers are appointed by the academic unit council.
- 8.4. 8.4. Reviewers are required to write a positive or negative review. Their relationship can be common or seperated.
- 8.5. The reviewers' report must be submitted within the deadline specified in the decision to appoint them.
- 8.6. The manuscript is accepted for further publication if it has at least two positive reviews.

### **Article 9**

- 9.1. The author must submit the manuscript and positive reviews of at least two reviewers. The manuscript should be printed on paper (with soft links) and in the original electronic version (Word, Late X etc.) and PDF (and sorted by computer ).
- 9.2. The manuscript of basic textbooks, other textbooks, internships and assignments should be in accordance with the syllabus and curriculum of the subject, respectively of that field
- 9.3. The manuscript must be proofread and corrected.
- 9.4. The author, together with the manuscript according to paragraph 3 of this article and the reviews, must submit the syllabus and curriculum of the subject in question, certified by the academic unit.
- 9.5. When applying, the authors sign a statement of authenticity of the work and other responsibilities.
- 9.6. The publishing council develops and approves the formulas for the application process.

### **Article 10**

- 10.1. The publishing council develops and approves the formulas for the application process.
- 10.2. In cases of eventual disagreement between the author and the reviewers with the editor's remarks, according to paragraph 1 of this article, the Publishing Council decides.

### **Article 11**

- 11.1. Advantages of publication are: original publications, especially for courses that do not have basic university textbooks and publications which with curricula are necessary literature for students;
- 11.2. Translations of basic texts of particular professional, scientific, literary and artistic importance.

### **Article 12**

12. I. University publications contain: University name, academic unit name, author name and surname, text title, the emblem of the University, place and year of publication.  
The first and second pages are empty.
2. The third page is the same as the front page, but without color.
3. The fourth page: the names of the reviewers, the president of the Publishing Council, the editor, the publisher (Haxhi Zeka University in Peja) and finally the decision number with this content: The Publishing Council of "Haxhi Zeka" University in Peja, allowed the publication and use of this text by decision no. dated xx.xx.xxxx.
4. Fifth page: content.
5. After the content follows the preface to the page number (on the right), the text of the publication, and after the text - literature, index of names, index of notions and on the

last page - name and surname of author, title of publication, name and surname of lecturer, proofreader, artistic editor, computer executor and author of illustrations.

6. Thanksgiving for sponsors can be on the penultimate page.
7. The text pages show the author's name and the title of the publication.
8. The publication also notes: All copyright is protected by law
9. The format of University publications is BS (17 x 24 cm). Sorting should be in Century Gothic font, font size 11, with rarity 1.0.
10. Special editions may have special technical and artistic solutions.
11. The last page of the publication contains the cataloging (CIP) of the National Library of Kosovo, and ISBN in the back cover.

### **Financing the publication of publications**

#### **Article 13**

13.1. The estimate of publication costs is expressed in foreign currency (Euro- €) and the published text page is calculated.

13.2.1. Points are assigned as follows:

13.2.2. Per editor - 1 € per page.

13.2.3. For reviewers - 2 € per page (amount divided by number of reviewers).

13.2.4. For proofreading & correction -1 € per page.

13.2.5. For the author / authors honorarium:

i) 1500 EURO for 70-99 page texts:

ii) 3000 Euro for 100-250-page texts;and

iii)  $3000 + 5(X-250)$  EURO, for texts of more than 250 pages (where X is the number of pages of text).

13.2.8. For task summary, praktikume:

i) 1000 EURO for 70-99-page texts

ii) 2000 EURO for 100-250 page texts; dhe

iii)  $2000 + 5(X-250)$  EURO, for texts of more than 250 pages (where X is the number of pages of text).

iv) 13.3. The fee for translation of university text will be 12 € per page

13.4. The royalties for the second edition will be 50% of the royalties for the first edition.

13.5. Author / authors royalties for the third edition onwards will be 30% of the royalties for the first edition

13.6. Only the author (s), not the editor, reviewers, proofreaders, and proofreaders, are compensated for the second edition.

13.7. In case of translation requests, the author (s) should contact the publishing house or authors in advance and be informed of the conditions for transfer of the right to translation, which will be taken into account in the UHZ Publishing Council decision. If the Publishing Council makes a positive decision, then UHZ (through the KLS) addresses the publishing house or authors with a formal request for the right to translation. Only after obtaining permission, the author (s) will be able to begin the translation and, once finalized, submit the next request

to the Publishing Council, including the reviewers' report and fulfill other requirements as in the case of other publications

13.8. The Rectorate of "Haxhi Zeka" University in Peja, compensates the author (s) with 50% of the proceeds from the sale of the publication. Compensation is made annually after the sale balance is issued

13.9. If the author has covered the publication costs, 80% of the proceeds from the sale will go to the author, and 20% to the University.

I 3.1 0. From the selling price of the publication belongs:

I 3.10.1. University - 85% of the sale price of the publication;

13 .10.2. Sales network - 15% of the sale price.

Since the establishment of the University Library (within the University Library), the publications will only be sold in that library and the funds are deposited into the University account.

Funds from the sale of publications are returned to the Rectorate according to the dynamics of the sale of publications

13.11. In any way of financing the publications (with UP funding or self-financing), the selling price and the place of sale are determined in the same way (and under this regulation), while the author (s) have no right to sell the book themselves, nor to impose its purchase on students,

#### **Article 14**

Publications are funded by University budget funds and other sources (sponsors, donors, funds raised from the sale of textbooks, etc.). Funds raised by sponsors and sales are collected in separate University accounts and used to support new publications.

#### **Article 15**

The provisions of this Regulation shall also apply to publications published by the author's means, with the exception of Article 13 (relevant paragraphs) and Article 14 of this Regulation.

#### **Article 16**

16.1. The sale price for each publication is calculated according to the amount of funds from 0.015- € per page of published text.

16.2. Prizes and other obligations between the publisher, the author and other entities provided for in this Regulation are determined by contract.

#### **Article 17**

17.1. Rektorati i Universitetit (Sektori i financave) e bën kompensimin e shpenzimeve të publikimit për shtypjen e publikimit në përputhje me procedurat përkatëse. Përgjegjës për mjetet financiare lidhur me botimin është prorektori për çështje materiale-financiare.

### **Article 18**

18.1. Any publication that refers to the attributes provided for in this Regulation without going through the foreseen procedures is considered to be an unlicensed publication and does not have university validity, respectively, legal measures are taken.

18.2. After publication, in cases where the publication is financially supported by UHZ, the publisher is obliged to submit:

I 8.2.1. Author of the publication - 10 copies;

I 8.2.2. Rectorate - 1 copy;

18.2.3. Library of the respective academic unit 5 copies;

18.2.4. National Library of Kosovo - 3 copies;

18.3. UHZ Central Library - 5 copies.

18.3.1. In cases where university publications are self-financed, the author is obliged to submit:

18.3.2. Rectorate - 1 copy;

18.3.3. Library of the respective academic unit 5 copies;

18.3.4. National Library of Kosovo - 3 copies

18.4. UHZ Central Library - 5 copies.

### **Transitional and Final Provisions**

#### **Article 19**

19.1. The President of the Publishing Council shall be responsible for the proper implementation of this Regulation

19.2. The authentic interpretation of this Regulation is provided by the UHZ Senate.

#### **Article 20**

20.1. Amendments to this Regulation shall be made in accordance with the approval procedure.

20.2. This Regulation shall enter into force on the day of its adoption by the UHZ Senate and applies to approved publications after the entry into force of this Regulation.

**Rector**

**Prof. Dr. Fadil Millaku**

---

Explanation: This regulation is translated in English but signed and protocolled in Albanian.